

**KONTRATA
E THEMELIMIT TË SHOQËRISË
"SAN" SHPK**



NENI 1

1. Z. Agron Shaplo me banim në Tiranë, rruga Thanas Ziko, Pall. 1, Sh2/Ap17,
2. Z. Serafin Orgocka me banim në Tiranë, rruga Hoxha Tahsin, Pall. 290/1 Nr. 17,
3. Z. Jordan Çaçi, me banim në Tiranë, rruga Abdyl Frashëri Pall. 16/1/3A,
4. Z. Agim Çami, me banim në Tiranë, rruga Kongresi i Lushnjës Pall. 39/Sh5/Ap51,
5. Z. Hysen Çabej, me banim në Tiranë, Bulevardi Bajram Curri, Pall. 1 Maj, Sh.9/Ap.22,
6. Z. Ilir Difeqiu, me banim në Tiranë, rruga Gjon Kastrioti nr.56, Laprakë,
kanë vendosur të krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.p.k.)

NENI 2

Shoqëria do të vepronë në përputhje me Dispozitat e Ligjit "Për Shoqëritë Tregtare", të Statutit të saj dhe të kësaj Kontrate.

NENI 3

Emëri i Shoqërisë është: SAN Shpk
Selia e Shoqërisë do të jetë: Rr. Pjetër Budi Pall. 39/1, Tiranë, Shqipëri.

NENI 4

Shoqëria ka objekt të veprimtarisë së saj:

- tregtimin e mallrave dhe lëndëve të para, export/importin e tyre, të paisjeve e pjesëve elektronike, informatike, mekanike, të telekomunikacionit, linja e makineri, të pjesëve të ndryshme të këmbimit, si dhe mallra e paisje të tjera që lejohet të tregtohen
- kryerjen e serviseve inxhinjerie, teknike, konsultimeve, projekteve, në fushat e Internetit dhe të gjitha shërbimeve që rrjedhin prej tij, Informatikës, Telekomunikacionit, dhe Elektronikës Profesionale
- kryerjen e detyrës së komisionerit, të agjentit tregtar, të ndërmjetësit ose/dhe të përfaqësuesit të firmave të huaja.

NENI 5

Kapitali themelor i shoqërisë është 100 000 lekë, e cila përbëhet nga derdhjet e kontributeve në para, si dhe i ndarë në 100 pjesë ku sejcila pjesë ka një vlerë prej 1 000 lekë.

Ndarja e kapitalit në mënyrë të detajuar paraqitet si vijon:

- I. 29 000 (njëzet e nëntë mijë) lekë ose 29 aksione i zotëron Z. Agron Shaplo
- II. 20 000 (njëzet mijë) lekë ose 20 aksione i zotëron Z. Serafin Orgocka
- III. 17 500 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë ose 17.5 aksione i zotëron Z. Jordan Çaçi
- IV. 17 500 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë ose 17.5 aksione i zotëron Z. Agim Çami

- V. 9 000 (nëntë mijë) lekë ose 9 aksione i zotëron Z. Hysen Çabej
VI. 7 000 (shtatë mijë) lekë ose 7 aksione i zotëron Z. Ilir Difeqçiu



Shuma e përgjithëshme e derdhur e kapitalit themeltar do të vërtetohet me anën e një dokumenti të lëshuar nga Banka.

NENI 6

Fitimet neto të realizuara do të ndahen në proporcion me pjesën e sejcilit ortak, e cila korespondon me kontributet e derdhura sejcilit syresh dhe me numrin e aksioneve që zotëron.

Z. Agron Shaplllo për të mbështetur punën administruese të shoqërisë dhe për të nxitur punonjësit që japin një ndihmesë të ndjeshme në mbarëvajtjen e saj, vë në dispozicion të shoqërisë deri në 5% të fitimit vjetor neto të saj (pra fitimin që i korespondon 5 aksioneve të tij).
Në rast se për nxitjen e aktivitetit të shoqërisë do të kërkohet një mbështetje më e madhe atëhere Asambleja e Ortakëve do të vendosë për masën dhe mënyrën e kontributit.

NENI 7

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet nga Asambleja e Ortakëve. Të drejtat dhe detyrat e administratorit përcaktohen në Statutin e Shoqërisë.
Asambleja e Ortakëve në mbledhjen e saj të parë zgjodhi Administrator të Shoqërisë Z. Jordan Çaçi.

Kjo kontratë nënshkruhet në Tiranë, më 28.01.1999.

Agron Shaplllo

Agim Çami


Serafin Orgocka

Hysen Çabej

Jordan Çaçi

Ilir Difeqçiu

STATUTI I SHOQËRISË SAN (SHPK)



I. KRIJIMI, FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË.

NENI 1

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar SAN Sh.p.k. është krijuar sipas Kontratës, që i bashkëlidhet ky statut, të përpiluar dhe të nënshkruar nga:

1. Z. Agron Shaplo me banim në Tiranë, rruga Thanas Ziko, Pall. 1, Sh2/Ap17,
2. Z. Serafin Orgocka me banim në Tiranë, rruga Hoxha Tahsin, Pall. 290/1 Nr. 17,
3. Z. Jordan Çaçi, me banim në Tiranë, rruga Abdyl Frashëri Pall. 16/1/3A,
4. Z. Agim Çami, me banim në Tiranë, rruga Kongresi i Lushnjes Pall. 39/Sh5/Ap51,
5. Z. Hysen Çabej, me banim në Tiranë, Bulevardi Bajram Curri, Pall. 1 Maj, Sh.9/Ap.22,
6. Z. Ilir Difeqiu, me banim në Tiranë, rruga Gjon Kastrioti nr.56, Laprakë,

Të gjithë ortakët ranë dakort për të zhvilluar veprimtari tregtare në Shqipëri, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, nëpërmjet shoqërisë SAN Shpk, të cilën ata ranë dakort ta themelojnë.

NENI 2

Shoqëria fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit të saj.

NENI 3

Emërtimi i Shoqërisë është: SAN Sh.p.k.

NENI 4

Shoqëria ka objekt të veprimtarisë së saj:

- tregtimin e mallrave dhe lëndëve të para, export/importin e tyre, të paisjeve e pjesëve elektronike, informatike, mekanike, të telekomunikacionit, linja e makineri, të pjesëve të ndryshme të këmbimit, si dhe mallra e paisje të tjera që lejohet të tregtohen
- kryerjen e serviseve inxhinjerie, teknike, konsultimeve, projekteve, në fushat e Internetit dhe e të gjitha shërbimeve që rrjedhin prej tij, Informatikës, Telekomunikacionit, dhe Elektronikës Profesionale
- kryerjen e detyrës së komisionerit, të agjentit tregtar, të ndërmjetësit ose/dhe të përfaqësuesit të firmave të huaja.

NENI 5

Selia e Shoqërisë do të jetë në Rruga Pjetër Budi, Pall. 39/1, Tiranë, Shqipëri.

Ajo mund të hapë filiale në të gjitha rrethet e vendit si dhe jashtë Shqipërisë.

NENI 6

Shoqëria ka vulën e saj ku është shkruar emri i saj.

NENI 7

Kohëzgjatja e Shoqërisë është 49 vjet, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj, përveç rastit të shkrirjes së parakohme ose të zgjatjes së afatit nga Asambleja e Përgjithëshme e ortakëve.

II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR.

NENI 8

Kapitali themelor i Shoqërisë është 100 000 Lekë, e cila përbëhet nga derdhjet e kontributeve në para, si dhe i ndarë në 100 pjesë ku secila pjesë ka një vlerë prej 1 000 Lekë.

Ndarja e kapitalit në mënyrë më të detajuar paraqitet si vijon:

- I. 29 000 (njëzet e nëntë mijë) lekë ose 29 aksione i zotëron Z. Agron Shaplo
- II. 20 000 (njëzet mijë) lekë ose 20 aksione i zotëron Z. Serafin Orgocka
- V. 17 500 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë ose 17.5 aksione i zotëron Z. Jordan Çaçi
- VI. 17 500 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë ose 17.5 aksione i zotëron Z. Agim Çami
- V. 9 000 (nëntë mijë) lekë ose 9 aksione i zotëron Z. Hysen Çabej
- VI. 7 000 (shtatë mijë) lekë ose 7 aksione i zotëron Z. Ilir Difeqiu

Shuma e përgjithëshme e derdhur e kapitalit themeltar do të vërtetohet me anën e një dokumenti të lëshuar nga Banka.

Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të saj, ortakët kanë të drejtë të rritjes së tyre në mënyrë proporcionale.

Të gjitha pjesët që formojnë kapitalin themeltar nënshkruhen plotësisht, pastaj shpërndahen ndërmjet ortakëve.

NENI 9

Procesi i transferimit të kapitalit ndërmjet ortakëve dhe i shitjes së aksioneve të tretëve ngurtësohet për një periudhë prej tre vjetësh. Menjëherë pas plotësimit të kësaj periudhe Asambleja e Ortakëve do të përcaktojë mënyrat e kryerjes së këtyre procedurave.

III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISË.

NENI 10

Ortakët e Shoqërisë përballojnë humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së tyre të derdhur në formën e kapitalit themelor.

Vendimet merren nga Asamblea e Ortakëve.

Çdo ortak merr pjesë në mbledhjet si dhe në nxjerrjen e vendimeve dhe disponon një numur votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron.

Një ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose edhe nga një person tjetër, të cilin e pajis me prokurë me shkrim.

Mbledhja e Asamblese mund të thirret nga çdo ortak që zotëron mbi 1/10 e pjesëve të kapitalit themeltar, nga Administratori, nga Eksperti Kontabël i autorizuar ose nga likuiduesit.

Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblese mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

Asamblea e zakonshme vendos me miratimin e ortakëve që zotërojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themelor për çështje të tilla si emrimi ose shkarkimi i administratorit, i ekspertit kontabël të autorizuar dhe likuiduesve, për miratimin e raporteve të administrimit dhe kontrollit, për miratimin e llogarive vjetore, të ndarjes së fitimit, etj.

Asamblea e jashtëzakonshme vendos për çështje të tilla si ndryshimin e statutit, zvoglimin e vlerës së pjesëve të kapitalit themeltar, transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, shndërrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në Shoqëri me forma të tjera, mbylljen e Shoqërisë para kohe, bashkimin ose ndarjen e Shoqërisë.

Asamblea e jashtëzakonshme vendos me miratimin e ortakëve që zotërojnë 3/4 e pjesëve të kapitalit themelor.

NENI 11

Shoqëria administrohet nga një ose disa administratorë, persona fizike, të cilët mundet të jenë edhe ortakë të Shoqërisë.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me miratimin e ortakëve që zotërojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themelor.

Administratori qendron në detyrë për një afat tre vjeçar, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm.

Administratori ka të gjitha kompetencat, që në emër dhe në dobi të Shoqërisë si dhe në përputhje me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë, të veprojnë në marrëdhënie me të tretët në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji dhe statuti ua jep shprehimisht ortakëve.

Asamblea cakton veçmas kompetencat e secilit administrator, duke bërë në këtë mënyrë një ndarje pune ndërmjet tyre.

Administratorët janë përgjegjës individualisht ose solidarisht sipas rastit ndaj Shoqërisë apo të tretëve, për shkelje të Ligjeve, për shkelje të Statutit apo për veprime të gabuara gjatë administrimit të Shoqërisë.

Asamblea e Ortakëve në mbledhjen e saj të parë zgjodhi Administrator të Shoqërisë Z. Jordan Çaçi.

NENI 12

Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga një ose disa ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen për tre vite financiare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Ekspteri kontabël emërohet dhe/ose shkarkohet nga mbledhja e ortakëve që perfaqësojnë me shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar. Eksperti kontabël shkarkohet në rast se shkel dispozitat Ligjore, Statutin ose edhe akte të tjera të Shoqërisë ose në rastin, kur për një ose tjetër arësye, bëhet e pamundur kryerja e detyrës së tij.

IV. VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, NDARJA E FITIMIT.

NENI 13

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjashtimisht viti i parë financiar fillon me ditën e regjistrimit të Shoqërisë.

NENI 14

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e veprimtarisë së vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Asamblea me vendimin e ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 6 muajve nga dita e mbylljes së vitit financiar.

NENI 15

Fitimi neto i realizuar nga Shoqëria, mbasi zbriten të gjitha detyrimet, si dhe fondet e lëna rezervë për investime, nxitjen ekonomike, reklamën tregtare, etj, ndahen ndërmjet ortakëve në proporcion me pjesën e kapitalit që zotëron secili prej tyre.

NENI 16

Bilanci vjetor i Shoqërisë nxirret brenda 31 Marsit të vitit pasardhës.

NENI 17

Shoqëria e perdor dhe e disponon pasurinë e saj në përputhje me qëllimet që përfshihen në objektin e veprimtarisë së saj të parashikuar në këtë Statut.

Shoqëria gezon të gjitha të drejtat për mbrojtjen e pasurive të saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 18

Detyrimet që mund lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, ajo i mbulon nga fondi rezervë, fondet e tjera ose nga shumat suplementare që mund të derdhen nga ortakët.

V. PUNËSIMET NË SHOQËRI

NENI 19

Për punonjësit që do të punësohen, marrëdhëniet juridike midis Shoqërisë dhe të punësuarëve do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 20

Shoqëria merr përsipër të bëjë sigurimin e të punësuarëve të saj në organet përkatëse duke derdhur rregullisht kontributet në përqindjen e caktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 21

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirkuptim, organi kompetent për shqyrtimin e tyre është Gjykata e Rrethit Tiranë.

VI. PRISHJA E SHOQËRISË DHE LIKUJDUMI

NENI 22

Shoqëria priset para kohe kur:

- aktiviteti i saj për një kohë të gjatë është me humbje.
- për arsye të parashikuara me ligj.

Prishja e Shoqërisë bëhet me miratimin e ortakëve që zotërojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themelor.

NENI 23

Shoqëria nuk priset kur njëri nga ortakët falimenton, bëhet i pa aftë, vdes ose tërhiqet nga Shoqëria.

Lidhur me veprimet që do të bëhen për pjesët e tij të kapitalit do të veprohet sipas përcaktimit të dhënë në NENIN 9 të këtij Statuti.



NENI 24

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asambleja emëron një ose disa likuidatorë të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit të pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

NENI 25

Mbas pagimit të kreditorëve, shlyerjen e të gjitha detyrimeve dhe shlyerjen e pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve, proporcionalisht me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin themeltar.

VII. DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 26

Të gjitha vendimet e Shoqërisë regjistrohen në një libër që mbahet në selinë e Shoqërisë. Proces-verbalet e mbledhjes së asamblesë së ortakëve ruhen gjithashtu në selinë e Shoqërisë.


NENI 27

Me vendim unanim të ortakëve, administratorit mund t'i delegohen kompetenca me të gjera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë.


NENI 28

Ky statut nënshkruhet në Tiranë më, 28.01.1999

Agron Shaplllo




Agim Çami



Serafin Orgocka



Hysen Çabej



Jordan Çaçi



Ilir Difeqiu

